



P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **27.10.2023**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes. **Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i Komunës, **Smajl Latifi**, nënkryetar **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje, së bashku edhe me zyrën e Kryetarit, kemi vendosur për këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i Raportit financiar janar – shtator 2023;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Draft-planin komunal të veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK) 2023-2030;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-00239-0, në zonën kadastrale Bërnjak;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-00236-0, në zonën kadastrale Bërnjak;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.29/23, i datës 28.2.2023, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër;
8. Shqyrtimi i vendimit për organizimin e mësimi joformal në institucionin e arsimit dhe aftësimin profesional në shkollën “Selajdin Mullabazio-Mici”;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të kryetarit të Komunës së Rahovecit për shpalljen QYTETAR NDERI të Komunës së Rahovecit, z.Erich Rathfelder, gazetar i Republikës së Gjermanisë.

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të kuvendit, a keni ndonjë propozim apo diskutim lidhur me këto pika të rendit të ditës.

Burim Krasniqi – Përshëndetje për ju kryesues, ekzekutivin, kolegë asambleistë, medie dhe gjithë të pranishëm. Pika e nëntë a do të jetë seancë tjetër solemne që do të mbahet e veçantë, apo është e së njëjtës seancë. Kështu që unë po rekomandoj që pika e nëntë e rendit të ditës të largohet si pikë e rendit të ditës se kësaj seance dhe në orën 14:00, kur të kemi seancën e jashtëzakonshme, të jetë e vetmja pikë e rendit të ditës dhe vazhdojmë tutje. Pasi si propozime kanë ardhur dy seanca për ditën e sotme dhe rekomandimi im apo si propozim është që pika e nëntë e rendit të ditës të largohet nga kjo seancë dhe të organizohet seanca solemne në orën 14:00 dhe ta ketë solemnitetin e plotë dhe jo me qenë si pikë e fundit, pasi edhe për nga rëndësia nuk është e fundit kjo por të jetë pikë e vetme. Kështu që pas një pauze që mund ta kemi pas seancës së rregullt edhe vazhdojmë me seancën solemne për shpalljen qytetar nderi.

Kryesuesi – Për sqarim, pika e nëntë është si pikë e rendit të ditës, mirëpo seanca solemne organizohet në orën 14:00, kështu që si pikë, me pëlqimin dhe miratimin e asamblesë të aprovohet dhe të vazhdohet pastaj me seancën solemne që është e paraparë të mbahet në orën 14:00 pas përfundimit të të gjitha pikave të rendit të ditës.

Burim Krasniqi – Nuk e vë në dyshim çështjen e shpalljes qytetar nderi, por vetëm po kërkoj mirëkuptimin që edhe në KPF, por edhe në ftesën që ka ardhur, kanë ardhur për dy seanca. Kështu që, të quhet seancë solemne e të jetë pikë e rendit të ditës së seancës së rregullt, nuk e ka edhe aq kuptimin sa mundem me logjiku. Pra, nëse është seancë solemne, atëherë është seancë e veçantë prej seancës së rregullt me pikën e veçantë. Kështu që po kërkoj mirëkuptimin që të mos mbetet si pikë e nëntë, por në orën 14:00, të fillojmë me seancën solemne me një pikë të rendit të ditës.

Ilir Pallqa- Me sa e di unë, në seancën solemne nuk ka të drejtë të votohet dhe kjo ndoshta është arsyeja që është vendosur me siguri.

Kryetari – Përshëndetje për ju kryesues, anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të KFOR-it dhe të gjithë të pranishmit në këtë seancë. Unë e kam respektuar një kërkesë që ka dalë nga KPF-ja, për shkak se zakonisht në seancën solemne e kemi bërë edhe miratimin e vendimit. Mirëpo nuk është keq që në seancën e rregullt me diskutu përgjegjësit e grupeve partiake që me diskutu rreth çështjes dhe arsyen pse kemi vendosur me shpall qytetar nderi gazetarin gjerman edhe me u marr vendimi pasi e kemi analizuar se nuk po preferohet se ndonjëherë ka ndodhur se kur e kemi shpallë qytetar nderi, në kohën duke e marrë vendimin edhe duke qenë prezent, nga dikush mundet me pas edhe diskutime, Prandaj e marrim vendimin tani dhe në seancën solemne vetëm e arsyetojmë atë që ka ndodhë në seancën e rregullt me ndonjë fjalim përshëndetës apo edhe arsyetohen rreth çmimit apo dekoratës që i ndahet. Pra, në seancën e rregullt kemi të drejtë me debat rreth gazetarit që i jepet titulli pasi kemi pasur raste që në seancën solemne me hedh në votim dhe sigurisht që mos me dërgu sinjale të mira të personi që shpallet qytetar nderi. Kështu që të gjitha argumentet janë në favor tonin dhe po besoj që në seancë të rregullt në pikën e nëntë diskutojmë me ndonjë fjalë përshëndetëse nga shefat e grupeve e sigurisht edhe nga anëtarët e tjerë të kuvendit dhe e marrim vendimin për shpalljen qytetar nderi, pastaj në seancën solemne e ndajmë dekoratën, kështu që kisha kërkuar që të mbetet kështu se ndoshta është më mirë, pasi edhe vet e keni kërkuar kështu në mbledhjen e KPF-së.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Atëherë, meqë nuk kemi diskutime sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hedhim në votim. Me shumicë të votave, aprovohet procesverbali i mbledhjes së kaluar. Kalojmë ne pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve

Ilir Pallqa – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë dhe gjithë të pranishmit në këtë seancë. Sot po mendojmë me fol për dashurinë, që realisht është një emocion kulminant i lidhjes së një personi me një person tjetër. Por, dashuria ka edhe dobësinë e saj, kuptohet, si çdo gjë e bukur apo edhe emocionale, ka edhe xhelozinë. Kështu që xhelozinë e dimë se si është, pasi ka xhelozinë që s'ka dëshirë me pa tjetrin mire por ka edhe xhelozinë kur ti dëshiron me qenë si tjetri, duke ia deshtë suksesin edhe atij. Në këtë rast unë hyj te kjo e dyta dhe unë po xhelozoj që Komuna jonë në masë të madhe është duke flirtuar me kompanitë e vendeve të tjera, kurse te ne nuk është bërë asgjë në orientimin e kompanive në përmbushjen e kushteve për fitimin e tenderëve. Unë po xhelozoj kur shoh zonën ekonomike funksionale në Suharekë, edhe pse në vitin 2013 ka qenë diskutimi për zonën ekonomike të përbashkët Rahovec-Suharekë, kurse sot Suhareka e ka zonën ekonomike, kurse ne nuk e kemi. Po ashtu, unë xhelozoj kur shoh urbanizim të vazhdueshëm në Malishevë, kurse kjo nuk po ndodh në Rahovec. Unë xhelozoj kur shkoj në Ferizaj, ku gjatë një dite pune të shtatorit e shoh të stërmbushur sheshin, kurse në Rahovec shohim hapësira të zbrazura, të mbushura me dhembje. Unë xhelozoj kur shoh klubin futbollistik të Klinës, duke marrë pjesë në gara evropiane, që mundeni me u arsyetu që nuk është kompetencë komunale, mirëpo ju duhet ta pyeteni homologun tuaj të AAK-së se si ka vepruar në gjetjen e donatorëve në Klinë, kurse te ne, sporti në përgjithësi është në rënie të lirë. Unë xhelozoj të gjitha komunat kur udhëheqësit e tyre e respektojnë fjalën e lirë, kur dëgjojnë kritikën për mospunë, kur pranojnë mendime e kur ekzekutojnë ide të qëlluara, kurse tek presim të ndodhë kjo. Dhe në fund, cili është ilaçi i xhelozisë, pra kjo pyetje shkon për ju kryetar.

Kryetari – Për shkak të seancës solemne që e kemi, ju kisha lutur kësaj radhe për të gjithë ata që bëjnë pyetje, që të na mirëkuptojnë që përgjigjet mund t'i marrin në seancën tjetër dhe do të ishte mirë me respektu këtë lutje të kryetarit të Komunes.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për ju kryesues, kryetarin, nënkryetarin, drejtorë të drejtorive, anëtarët e kuvendit komunal, përfaqësues të KDI-së, LMT-së, OSBE-së, medie dhe gjithë të pranishmit në këtë seancë. Pyetja ime shkon për drejtorin e Shërbimeve Publike, pasi ka shumë kërkesa të qytetarëve që kanë nevojë për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit, a ka mundësi me iu shpërnda gropa për kanalizim, që me iu dalë në ndihmë, pastaj pjesën tjetër të punimeve e kryejnë vetë.

Burim Krasniqi – Duke mos dashur të kërkoj përgjigje sot, për shkak të ceremonisë solemne që e kemi, i kam disa pyetje fillimisht te Drejtoria e Bujqësisë, kam informatë apo ankesë për shkak se bujqve që iu kanë dëmtuar prodhimet e tyre prej të reshurave, si pasojë e vërshimeve, nuk janë kompensuar, kështu që a nuk po e kompenson ministria sipas kriterëve, apo si mund të bëhet kjo zgjidhje, pasi në këtë vit, bujqit, problemin kryesor e kanë për shkak të të reshurave dhe vetëm një pjesë e vogël për shkak të breshrit. Pastaj, te Drejtoria e Arsimit, e kam bërë para katër seancave një pyetje dhe nuk më keni dhënë asnjë përgjigje, pra sa punëtorë të arsimit i kemi me normë jo të plotë dhe kur janë pranuar këta arsimtarë. Po ashtu, cilat lëndë janë sfiduese për komunën e Rahovecit sa u përket kuadrove dhe në sa shkolla kemi problem si komunë rreth mungesës së kuadrove profesionale, si matematikë, fizikë apo lëndë të tjera që janë specifike. Po ashtu, nëse ka mundësi drejtori me na përcjell një statistikë se sa është numri i mungesës së nxënësve në shkollat e mesme të larta.

Dëfrim Kafexhiu - Përshëndetje për ju kryesues, kryetarin, nënkryetarin, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, monitorues, medie dhe gjithë ju të pranishëm. Më herët kryetari e tha se për këtë seancë po kërkon

mirëkuptimin nga asambleistët për përgjigjet që mund t'i marrin, për shkak të kohës për seancën solemne, por unë po besoj që anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët e komunës, nuk kanë nevojë për përgjigjet e kryetarit kundrejt pyetjeve tona, por më shume ka nevojë për punën e kryetarit, kështu që ne nuk po presim përgjigje nga ju kryetar, por presim punë. Sa i përket arsimit në komunën e Rahovecit, prej një këndvështrimi të përgjithshëm që po del i dhimbshëm dhe nëse e shikojmë si interes vital për komunën tonë. Në seancën e kaluar, fola për mungesën e kuadrove dhe për atë se çfarë mund të bëjë komuna si institucion për të rregulluar këtë çështje në bazë të kompetencave që i ka. Qeverisja e Smajl Latifit e ka degraduar sistemin arsimor në komunën tonë, fillimisht duke vendosur një drejtor jokredibil dhe joadekuat si bartës të proceseve arsimore në Rahovec. Nuk po e gjykoj këtë sepse një kryetar i tillë sigurisht se do të vendoste një vasal të tij e të tillë për të udhëhequr arsimin në formën qysh janë mësuar t'i udhëheqin institucionet. Arsimi në komunën tonë është skajshmëri i politizuar dhe po flas për këto dy vitet e fundit të këtij mandati pasi për mandatin e kaluar duhet më shumë se një orë për të përmbledhur dëmin që është bërë. Kështu që drejtor Avni Morina dhe kryetar Smajl Latifi, a mund të më thoni një emër të një mësimdhënësi që është punësuar pa intervenime dhe pa ndikim politik, pra unë po dyshoj që ka dhe nëse ka, atëherë ju ftoj që t'i shuani dyshimet e mia. Për dy vite janë punësuar një numër i madh i stafit arsimor në çdo nivel të shkollimit në komunën tonë dhe të gjithë prej tyre janë punësuar me intervenime, veç disave që ndershmërisht ju priu fati pa konkurrencë për pozita specifike në mësimdhënie. Ju e keni shkatërruar sistemin arsimor, sepse drejtorin e arsimit e shihni vetëm si burim i punësimeve partiake dhe asnjëherë si shërbim ndaj nxënësve e mënyrë të zhvillimit të burimeve njerëzore, qofte për komunë apo me gjerë, d.m.th. e keni politizuar arsimin deri në palcë dhe ju e dini se çka keni bërë e për këtë edhe i dërgoni fëmijët tuaj nëpër shkolla private, pasi 3 autobusë me nxënës, çdo mëngjes shkojnë në shkolla private, pra janë mbi 150 nxënës të Rahovecit që nuk preferojnë shkollimin nëpër shkollat e komunës tonë. Kështu që unë po besoj që ju këtë dëm e keni bërë pa vetëdije dhe prapë nuk e besoj që ju jeni aq të këqij sa ta bëni një gjë të tillë, pasi ka shumë çështje të tjera në arsim si driblimet e drejtorit me orare të mësimt, me normën mësimore, se si favorizohen ata që janë pjesë e partisë së Aleancës dhe anashkalohen ata që janë të partive të tjera. Por, asnjëherë mos harroni se jeni duke e shkatërruar këtë sistem dhe jeni duke e dëmtuar të ardhmen e nxënësve e po e privoni zhvillimin e komunës çdo ditë e me shume. Po ashtu po dëgjoj këtu që vazhdimisht e mbrojnë këtë sistem, që realisht nuk kanë aspak kredibilitet për shkak të mënyrës se rahatisë në këtë sistem, pra disa që quhen mësimdhënës e që veprimet i kanë për të ardhur keq, disa që duke qenë në opozitë e kanë plotësuar normën mësimore prej këtij pushteti, kurse disa që kanë mbetur pa pozita janë bërë mësimdhënës si kompensim politik. Kështu që mundohuni me i kursy qytetaret me lëvdata për këtë sistem se sa për neve e dimë shumë mirë, por nuk e di si mundeni të flini të qetë duke e përdhosur këtë epitet të çmuar që e mbani pa meritë, duke dashur të barazoheni me ata që vërtet kanë vlera.

Sejfullah Sejfullahu – Përsëritet për ju kryesues, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolegë asambleistë, OSBE-ja, KFOR-i, medie dhe të gjithë të pranishmit. Kërkesa ime shkon për drejtorin Perparim Krasniqi rreth ndriçimit në Krushë, që ka mbetur segmenti që shkon deri te shtëpia-muze "Ukshin Hoti", edhe pse nuk e keni paraparë në buxhet, a do të kishte mundësi rruga që shkon skaj përroskës, që del te shtëpia-muze, do të ishte mirë të ndriçohet edhe kjo rrugë, pasi nuk është ndonjë investim i madh. Kështu që a mundemi me shpresu që me u kry edhe kjo punë e ndriçimit të asaj rruge.

Shqipe Kryeziu - Pyetja ime ka të bëjë me drejtorin e Shërbimeve Publike, konkretisht në fshatin Fortesë në rrugën Fadil Gashi, e kam paraqitur edhe me herët këtë rast, pasi dritat nuk funksionojnë hiç. Kështu që pyetja ime është se a do t'i rregulloni këto drita apo do t'i zëvendësoni me drita digjitale smart në këtë fshat.

Leonard Morina – Përsëritet kryesues, kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë dhe gjithë të pranishmit në seancë. Në komunën e Rahovecit, në vitet e fundit, kemi mungesë të mësimdhënësve të kualifikuar për lëndën e matematikës dhe kjo duhet të jetë shqetësuese për Drejtorinë e Arsimit për shkak se

tani dihet mungesa e mësimdhënësve të matematikës. Dhe ne e dimë se mungesa e kuadros së kualifikuar, Drejtoria e Arsimit detyrohet të pranojë kandidatë të cilët nuk janë të kualifikuar për matematikë dhe as për mësimdhënie, por pranon drejtime të përafërta. Po ashtu këso probleme me mungesë të kuadrove kanë edhe qytete të tjera si Gjakova, Malisheva, Suhareka e shumë qytete të tjera. Pyetja për drejtorin e Arsimit është se a keni ndërmarrë diçka për të mos e thelluar më shumë mungesën e kuadros dhe a i jeni drejtuar ministrisë së Arsimit me ndonjë kërkesë, a ia keni shprehur si shqetësim mungesën e kuadrove, apo të kërkonin nga ministria që të rihapet drejtimi në fakultetin e edukimit për mësimdhënës të matematikës, se paku që pas 4 viteve të kemi kandidatë të kualifikuar. Pyetja e dytë, meqenëse në konkursin e mëhershme, siç e ceka, në mungesë të kuadros së matematikës, keni pranuar kandidatë që janë me profile të përafërta dhe logjikisht kjo është në rregull për shkak se më mirë është t'i mbajë orët dikush që është me profil më të përafërt se sa të humbin nxënësit. Kështu që pyetja ime është se pse e keni anuluar konkursin për infermierin në shkollën profesionale me arsyetimin se nuk ka pasur kandidatë të kualifikuar, pse nuk keni vepruar si me herët që t'i pranoni kandidatet me drejtimin me të përafërt që të mos humbin orët dhe me sa e di unë, nga shtatori, nxënësit nuk janë duke i mbajtur këto orë. Pyetja e fundit për çerdhet që po ndërtohen nga Ministria e Arsimit apo nga qeveria Kurti, tani po shihen që po fillojnë ndërtimet në disa komuna dhe ku është Komuna e Rahovecit me ndërtimin e çerdheve që do të ndërtohen nga ministria.

Lirigzon Kastrati – Përsëritet për ju kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, medie dhe të gjithë ju të pranishëm. Unë sot nuk do të flas për fshatin Hoçë e vogël dhe Brestoc, pasi dëshiroj të deklarojmë rreth dy çështjeve jashtë rendit të ditës, ku fillimisht me drejtorin e Arsimit ku dua t'i kërkoj disa sqarime shtesë, sa i përket zhvillimit të arsimit në komunën tonë dhe në këtë drejtim dëshiroj të njoftohem nga drejtori i arsimit se çfarë niveli i sigurisë qëndron në shkollat e komunës tonë, a realizohet ndonjë kontroll rutinë për posedimin e sendeve të rrezikshme apo ndonjë dukuri negative që mund të ndodhë në shkollat tona. Këtë çështje po e ngre sepse është në interesin e të gjithëve të dimë se çfarë niveli i sigurisë dhe çfarë dukuri negative mund të zhvillohen në shkollat tona dhe kërkoj që të parandalohen këto dukuri. Pastaj çështje tjetër ka të bëjë me Drejtorinë e Shëndetësisë, ne sot kemi pasur një takim të Komitetit për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale në vizitat që i kemi bërë në qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancat familjare, që duhet me i falënderu mjeket për punën dhe gatishmërinë e tyre, mirëpo duhet me iu plotësu kushtet, si qëndron e kontratës me higjienën pasi mungon materiali për higjienë, a ka marrë ndonjë veprim drejtoria e shëndetësisë pasi këtë çështje e kemi ngritur paraprakisht edhe në seancat e kaluara, kështu që dëshiroj që të na njoftoj drejtori se si ka vepru Drejtoria e Shëndetësisë në lidhje me higjienën nëpër qendrat e mjekësisë familjare.

Shqipe Kryeziu – Si mësimdhënëse dua të kontribuoj derisa jam në institucionin e arsimit dhe aftësimin profesional “Selajdin Mullabazi- Mici” dhe dua të ndërlidhem me kolegun Leonardin. Pyetja ime ka të bëjë me drejtorin e arsimit pasi në faqen ueb të komunës e pashë me numër protokoll Nr.137, i datës 25.10.2023, ku ne njoftim, Drejtoria e Arsimit e bën anulimin e konkursit me NR.041384, të datës 24.10.2023, ku ne këtë njoftim ceket se kandidatët nuk i kanë plotësuar, d.m.th. nuk kanë qenë adekuat. Pra, njoftimi është i qartë dhe i sigurt, mirëpo për rishpalljen ne e dimë se sa kohë merr dhe gjithashtu kam përshtypjen për ju drejtor se keni njohuri të mëdha në fushën e arsimit, pasi keni mbi 20 vite përvojë të punës në arsim dhe pyetja ime ka të bëjë se a jeni konsultuar me zyrën ligjore që me pas mundësi me gjet një modalitet për këta nxënës që puna me u vlerësu, pra behet fjalë për drejtimin e infermierisë që janë të regjistruar në vitin akademik 2023/2024, pra e keni në ligjin e punës, kreu i tretë i nenit 17-të, paragrafi i 2-të.

Valmir Gashi – Përsëritet për ju kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolege asambleistë, medie dhe të gjithë ju të pranishëm. Kërkesa ime ka të bëjë me drejtorin e Shërbimeve Publike, Përparim Krasniqi, në fshatin Sapniq është ndërtuar një lagje afërsisht 6 apo 7 shtëpi që një kohë dhe kanë nevojë për

një kanal të ujërave te zeza, pasi është krijuar një grope e madhe përball varrezave dhe gjithë kanalizimi kalon aty skaj varrezave dhe kjo nuk është mire dhe ka kriju edhe konflikte verbale mes banoreve aty, kështu që nëse keni mundësi me urgjencë të intervenohet në atë pjesë për ndërtimin e kanalit të ujërave te zeza.

Kryetari – Ju falënderoj për mirëkuptimin, pasi nuk po provoj me ju kthye përgjigje pasi ato do ti merrni qoftë me gojë apo me shkrim në seancën tjetër që përgjigjet me qenë sa me të qarta dhe konkrete. Gjithashtu në vazhdimisht po punojmë dhe vazhdimisht ju japim llogari qytetareve të komunës dhe veprimet në pajtim me ligjin. Kështu që gjithmonë qytetari ka nevojë për përgjigje dhe pikërisht qytetari është ai që vlerëson se përgjigjet ai ishin të drejta të sakta konkrete dhe për këtë janë në dijeni të gjithë.

Merisa Sharku - Përsëritet për të gjithë. Viti 2025 po afrohet, në të cilin vit është pretenduar përfundimi i punimeve në sheshin qendror pranë parkut të qytetit. Mirëpo, duke e parë tempon e punës që po bëhet aty atëherë shumë problem që do të kryhet sa në vitin 2030. Kështu që nga 10 marsi 2023 bëhen sot 7 muaj e 17 ditë nga përfundimi i këtij sheshi dhe janë kryer me pak se 10% të punëve që duhet kryer. Pra do ta kishim në konsideratë kohën po të dilte diçka e bukur dhe e shfrytëzueshme por duke parë kohën e marrë për projekte të tjera dhe funksionimin final të projekteve atëherë lë për të dëshiruar. Dhe kjo ndodh për shkak të keqprojektit, keqmenaxhimit, keqimplementimit dhe shume të keqijave të tjera. Kërkesat e njëpasnjëshme për konsultim me ekspertë të fushave, nuk janë përfill dhe për këtë arsye kemi projekte finale, qysh është qendra e qytetit që është totalisht jofunksionale.

3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Janar – Shtator 2023.

Afrim Limani – Përsëritet për ju kryesues, kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm. Raporti Financiar janar-shtator përmbajtjen e ka prej 3 pjesëve, pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimeve dhe pjesa e prokurimit apo aktiviteteve të cilët janë zhvilluar në kuadër të kësaj drejtorie me theks të veçantë kontratat e lidhura deri më 30 shtator. Të hyrat në total në këtë periudhë kanë qenë 1,450,000 euro dhe nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë të hyrat e rregullta kanë një diferencë pozitive apo tejkalim prej 521,579 euro, që janë të hyra të rregullta. Gjithashtu e kemi edhe raportin me të hyrat bashkë me gjobat e gjykatave dhe të trafikut edhe pas dërgimit të materialit në adresë tuajën, neve na ka ardhur edhe raporti për tremujorin e tretë të këtij viti, atëherë të hyrat në total bashkë me gjobat e gjykatave dhe të trafikut janë 1.586,742 dhe kur i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë diferenca është 462,153 euro. Pra, krejt ky ndryshim i rritjes së të hyrave që është rekord në raport me vitet e tjera është kryesisht në kuadër të rritjes së tatimit në pronë. Shpenzimi i buxhetit në total për këtë periudhë është 14,394,678 euro apo 76.79%. Gjithashtu në këtë periudhë ku unë tani raportoj shpenzimi i buxhetit është afërsisht 83% që konsideroj që është shpenzim i mirë në periudhën në të cilën gjendemi dhe shpresoj që sipas këtyre dinamikave deri në fund të vitit fiskal buxheti do të shpenzohet deri në 98%. Krejt në fund të raportit i kemi edhe kontratat që janë lidhur në kuadër të zyrës së prokurimit ku vlera e kontratave të lidhura deri më tash janë 4,973,750 euro.

Ilir Pallqa – Tek shërbimet e avokaturës, sa me kujtohet asambleisti Sinan Kryeziu ka thënë diçka sa i përket kësaj teme dhe kryetari e kishte kundërshtuar se nuk shkojnë me shume se 5000 euro dhe asambleisti Sinani, pati deklaruar se të gjitha kontestet janë të humbura, kështu që çdo cent është hedhur pra kemi gati 100,000 euro të humbura.

Leonard Morina – Unë jam ndalur të disa pika në raportin financiar rreth disa planifikimeve të paplanifikuara. Kështu që nëse e shohim kodin 50026, taksa për legalizimin e objekteve janë planifikuar 21,000 euro kurse janë realizuar zero euro, pastaj në arsim tek ora mësimore bëhet planifikimi realizimi reflektimi dhe krejt në fund bëhet vetëvlerësimi. Kështu që unë kam një pyetje për drejtorin pasi planifikimi po e shoh e gjithashtu edhe realizimi po shihet, kështu a ka mundësi me ditë se a ka reflektim dhe pse ka ndodh që nuk keni mundur as 1% të planifikimit me realizu dhe kjo i bie se ka dështuar i gjithë planifikimi. Te kodi 50032, taksa për certifikata

të pronësisë, ku keni planifikuar zero euro, ndërsa janë realizuar 14,000 euro, kështu që a e konsideroni këtë si dështim, apo si sukses i realizimit. Te kodi 50507, inspektimi higjenik sanitar, ku keni pasur planifikim 500 euro, kurse realizim zero euro dhe pyetja ime është[se a ka pasur inspektim ne terren dhe nëse po, atëherë gjatë inspektimeve a ka pasur vërejtje dhe cilat lloje te bizneseve janë inspektuar dhe te mos vije puna sikur ne Malishevë të helmohen mbi 200 qytetarë pastaj te dalim ne terren dhe t'i mbyllim bizneset. Te kodi 13420 shërbimet e avokaturës prej 41,000 euro, pasi një avokat për 9 muaj ja ka marr komunës këtë shume prej 41,000 euro. Kështu që pyetja ime është se avokati a i ka shërbimet e shtrenjta apo komuna ka lëndë shume sa që i kushton kjo shume për nëntë muaj. Unë besoj që komuna duhet ta rregulloj imazhin që mos te ketë procese gjyqësore kaq shumë dhe te jetë me korrekte me vendimet që i merr gjatë procedurave. Dhe kësaj nëse i shtojmë edhe 21,000 euro te shërbimet e gjykatës që i merr atëherë del rreth 62,000 për këtë periudhë 9-mujore. Pra do te ishte me mirë që me shumen prej 62,000 euro te nënshkruheshin 3 kontrata për shkolla që janë nga 20,000 euro te pajisen bibliotekat me libra shkollorë se sa te shkojnë dëm ne procese gjyqësore.

Hasan Përboqi – Përsëritet kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë te drejtorive, kolegë asambleistë, medie dhe gjithë te pranishmit. Së pari e përgëzoj Drejtorinë e Financave për përgatitjen e këtij raporti financiar, pasi është një raport i paraqitur ne detaje. Po ashtu, pajtohem me parafolësin Leonardin, që tha se si munden me u rrit të hyrat ne inspektorat dhe gjithashtu pajtohem se të hyrat nuk kanë dalë ashtu si janë planifikuar dhe ne këtë rast unë mund te jap një ide se si mund te rriten te hyrat ne inspektorat qe me pas mundësi me dal jashtë planit te planifikuar. Njëra prej ideve është që drejtoria me i qitë inspektoret ne terrene dhe me shiku vendimin e ri nga ministria e ambientit se sa po zbatohet, pra vendimi ne lidhje me pagesat për qese plastike, pasi unë kam ankesa te vazhdueshme edhe me kupon fiskal te dëshmuar që qeset plastike qytetarëve apo konsumatorëve me reklama dhe kjo është e ndaluar me vendim te ministrit te Ambientit. Mandej mundësia tjetër është inkasimi i të hyrave pasi po shihet se ne krahasim me vitin 2022 se ka një rritje mbi 500,000 te hyrave vetanake që realisht është një lajm i mirë dhe duhet me i falënderu qytetaret e komunës tonë si taksapagues te rregullt që janë dhe që janë për çdo lavdatë që i kryejnë detyrimet e veta që i kanë ndaj komunës. Pastaj te realizimi i buxhetit, brenda kategorive te veçanta mundet me pas pengesë ne realizimin e kodeve te veçanta ne realizimin e buxhetit por diku tjetër mundet me pas edhe tejkalime por e përgjithshmjia është se mbi 76% e buxhetit është realizuar dhe kjo është mirë pasi kemi nxitje edhe te qytetareve me pagu me kohe dhe me rregull obligimet që i kanë ndaj komunës pasi këto obligime po dëshmohej me shpenzim te buxhetit që po kthehen te qytetaret.

Afrim Limani – Unë prita me na dhanë ndonjë kompliment për shkak se kemi bërë inkasim rekord të të hyrave. Te pyetja për shërbimet e avokaturës, ne kemi te lidhur një kontratë dhe ajo kontratë është me çmim njësi shpenzimi dhe deri me tash ka kaluar 41,000 duke ditur që edhe një pjese te shpenzimeve janë te bartura nga viti i kaluar. Pastaj taksa për legalizimin e objekteve, nëse ju kujtohet ne fillim kur e kam prezantuar buxhetin edhe si kategori e të hyrave kamë thënë se momentalisht ka skaduar një vendim për legalizim te objekteve dhe ne konsultim me drejtorin e urbanizimit atëherë kemi marr premtime se brenda këtij viti do te rikthehet ai vendim dhe ne jemi detyruar me qit planifikimin. Pastaj te taksat tjera si taksa higjenik sanitar edhe taksa për certifikata te pronësisë për shkak te planit kontabël atëherë ngatërrohet pasi këtu nuk kemi bërë planifikim por e kemi për afërsisht te ngjashme atëherë inkasim ne vend që të bëhet ne kuadër te atij kodi, ka kaluar për shkak te planit ne softuer ne databazë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Draftplanin komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë (PKVEK) 2023-2030.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për ju kryesues, kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, OSBE, LMT dhe gjithë të pranishmit në seancë. Gjithashtu të pranishëm janë edhe përfaqësues të kompanisë pasi nëse kemi ndonjë pyetje apo rekomandim nga ky dokument atëherë do të jenë të gatshëm të japin ndonjë përgjigje. Pra ky dokument është mbështetur nga GIZ-i gjerman dhe është një model në nivel të Kosovës dhe plani ka afat nga viti 2023 deri në vitin 2030. Plani komunal i veprimit për Energji dhe Klimë ka disa specifika, pasi elementin kryesor e ka analizën e situatës aktuale pastaj objektin, strategjinë, masat, koordinimin dhe në fund e ka monitorimin dhe raportimin. Në kemi pasur një grup punues me vendim të kryetarit, i cili ka ofruar të dhënat për kompaninë e cila ka hartuar këtë dokument dhe detajet i keni në dokumentin final që është bërë dhe për çdo informatë dhe çdo gjë që ju intereson rreth këtij dokumenti atëherë do të jemi të gatshëm të japim përgjigje dhe sqarime shtesë.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi diskutime rreth kësaj pike të rendit të ditës, e hedhim në votim. Me shumicë të votave miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-00239-0, në zonën kadastrale në Bërnjak

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë drejtorë, anëtarë të Kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm. Në mbështetje të ligjit për vetëqeverisje lokale statusit të komunës së Rahovecit, kryetari i komunës ka propozuar para jush vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00239-0, në zonën kadastrale në Bërnjak, prej pjesës së përgjithshme prej 10 ari ndahet pjesa për interes të përgjithshëm prej 56 m². Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm është që përkaj këtij kufiri të ndërtohet edhe një urë tjetër me kërkesë të fermerëve, që faktikisht të dy parcelat që do të prezantoj në vijim gjinden përkaj lumit Dullo në drejtim të Fortesës. Qëllimi i këtij interesi të përgjithshëm është që në seancat e radhë kur të vjen edhe ligjshmëria të bëjmë këmbimin e pronës publike me pronë komunale për ndërtimin e urave për qasje të fermerëve prej një ane në anën tjetër.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-00236-0, në zonën kadastrale në Bërnjak.

Afrim Oruqi – Edhe kjo pikë e rendit të ditës, në mbështetje të ligjeve të aplikueshme të Kosovës, kërkojmë që të shpallet me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës P-00236-0, në zonën kadastrale në Bërnjak. Pra, edhe për këtë pikë qëllimi është i njëjtë që pas interesit të përgjithshëm të këmbëjmë këtë parcelë private me parcelën komunale që do të shërbej zgjerimin e hapësirës për ndërtimin e urës në këtë zonë. Pas ligjshmërisë atëherë kadastra do të kujdeset që të shpall në njoftimin publik pas hyrjes në fuqi. Ftojë anëtarët që të votojnë këto dy pika veç e veç sipas rendit të ditës.

Defrim Kafexhiu – Përshëndetje për të gjithë. Unë i kam dy pyetje për drejtorin edhe pse personalisht mendoj se punimet duhet të ndalen të ajo pjesë edhe pse është afër finalizimit. Kështu që pyetja ime është se a do të kryhen punimet 90% ashtu si janë krye punimet e atij shtrati apo do të përmirësohet kualiteti sipas specifikave që janë kërkuar në atë tender, pasi aty është një marri e radhës e këtij pushteti të aleancës në Rahovec dhe ato punë nuk shihen në mënyrën jo të duhur dhe janë shumë larg paramasave që janë kërkuar sipas projektit dhe duhet të merret me atë çështje nga hetuesia pasi dikush duhet me dhanë përgjegjësi për atë punë. Dhe unë nuk po besoj që na bën nder me krye atë punë ashtu deri në fund pasi njëjtë ka me vazhdu kualiteti i atyre punimeve dhe unë po besoj se pari duhet me u krye një hetim dhe me marr një epilog ai projekt, pasi vërtet shihet për shkak të kualitetit të dobët dhe shumë larg në bazë të asaj që është kërkuar.

Afrim Oruqi – Në parim jemi dakorduar në fillim që të përgjigjemi me shkrim por pas një akuze të tillë po besoj që kjo nuk na bën nder as neve e as qytetarëve nëse nuk reagojmë. Kështu që pas krejt këtyre akuzave, propozimi ishte që me shpall interes të përgjithshëm një pjesë të parcelës për me ndërtu një urë sipas kërkesës së fermerëve. Kështu që nëse keni dyshime për këtë atëherë ju ftoj publikisht ashtu siç po akuzoni publikisht,

që me i njoftu ato organe, pasi këtu ka një kontratë, një menaxher pastaj edhe një mbikëqyrës te menaxherit, por pika është për interes te përgjithshëm për këmbim.

Dëfrim Kafexhiu – Unë mendoj se edhe ju e dini se si është punuar aty por organet përkatëse janë te njoftuara dhe po besoj që do te marrin hapa ne ditët ne vijim dhe ju nuk duhet që ta mbulonit këtë me interes të përgjithshëm, kështu që para kësaj duhet te kryhet një hetim i caktuar dhe me pastaj me vazhdu me procedura të tjera për implementimin e këtij projekti. Kështu që nuk ju pyeta juve personalisht por te gjithë nga ekzekutivi që e kanë përgjegjësi këtë pjesë e i dhashë dyshimet për ata, pasi unë e di çfarë kompetenca ka Drejtoria e Kadastrës, por edhe drejtori, kështu që nuk duhet te mbulonit punën e keqe që është bërë ne terrene me çështjen e interesit te përgjithshëm.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim në votim. Me shumicë të votave miratohet pika e pestë e rendit te ditës. Po ashtu, e hedhim ne votim edhe pikën e gjashtë. Edhe kjo pikë me shumicë te votave te anëtareve te kuvendit, miratohet. Kalojmë ne pikën e shtatë te rendit te ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.29/23, i datës 28.2.2023, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër.

Afrim Oruqi – Në konsultim te plotë me Zyrën Ligjore, me kërkesë te kuvendarit Burim Krasniqi dhe ne e kemi konsultuar Zyrën Ligjore dhe është mirë me ndjek rrugën e plotësim-ndryshimit ose të shfuqizimit dhe ne bashkëpunim me zyrën përkatëse të MAPL-së, kanë konstatuar se duhet me ndjek rrugën e vendimit për shfuqizim, për arsye se ndryshon komplet vendimi përveç rregullores, pasi bëhet fjalë për një rregullore tjetër dhe komplet preambula ndryshon. Prandaj, para jush kemi sjellë në bazë te këtyre ligjeve ne fuqi vendimin për me shfuqizu vendimin e datës 28.2.2023, me dhënë një tokë komunale ne shfrytëzim deri ne 15 vite dhe kjo tokë gjendet ne zonën kadastrale ne Rahovec, te Maja e Shkodranit me sipërfaqe prej 1 hektar e 50 ari. Dhe ne te njëjtën kohë po e shfuqizojmë me këtë vendim edhe vendimin për formimin e komisionit për me i ndjek procedurat ligjore për me dhanë këtë pronë me qira nëpërmjet ankandit publik. Kështu që ju ftoj me votu këtë vendim për me i shfuqizu këto dy vendime pra vendimin për me dhanë këtë pronë me qira dhe vendimin e komisionit që do t'i ndjek këto procedura të ankandit publik. Pra, ne i kemi ndjekur dy ankande publike, mirëpo nuk ka pasur te interesuar për shkak te shumës që është e parapare me rregullore komunale.

Defrim Kafexhiu – Përshëndetje për te gjithë! Unë po besoj që ajo rregullore që drejtori po i referohet për me largu prej preambulës, ka dalë prej këtij kuvendi dhe e votuar ne këtë kuvend edhe nuk po besoj që kuvendi dhe komuna e Rahovecit mundet me dal përtej kësaj rregullore për dhënien ne shfrytëzim te këtyre pronave. Pasi unë po besoj se ka dyshime për dhënien e parregullt te pronës se paluajtshme te komunës për shfrytëzim personave te caktuar edhe nuk po besoj që është e udhës me u shfuqizu ky vendim edhe me u dhanë me njëfarë forme tjetër. Ne mbledhjen e KPF-së e thash se në bazë të rregullores të cilës drejtori po i referohet çmimi minimal për dhënie ne shfrytëzim është i përcaktuar dhe nuk po besoj që komuna e Rahovecit ka interes që me u dhanë me një far forme tjetër që do ti kushtonte me shume interesit te përgjithshëm dhe do te ishte me shume te interesit personal te personave te caktuar.

Burim Krasniqi – Procesi i dhënies ne shfrytëzim e kemi diskutuar edhe ne KPF i ka dy opsione, që thirret ne dy rregullore, pra ajo që jepet me lehtësira duke i mundësuar ne periudha te caktuara pa pagesë kurse periudha tjetër me 50% te pagesës, kështu që nuk dua me paragjyku asgjë dhe kërkoj mirëkuptimin e drejtorit, kryetarit dhe te asamblistëve që ky vendim të shfuqizohet dhe pastaj vendimi i ri kur bëhet te jetë konform rregullores. Kriteret e përcaktuara nga komisioni për dhënien në shfrytëzim të sillen ne asamble komunale te votohen prej asamblesë, kështu që plani i biznesit i investitorit te jetë i qartë për asamblenë ose te ketë kriteret te koston investive pastaj numrit te punëtorëve, kushteve tjera që neve si asamble te na fle ne shpirt që nuk po i mundësojmë dikujt me perfitu neper rrugë te tjera por te bëjmë punën tonë ashtu që na takon.

Kryetari – Në cilësinë e kryetarit të komunës, jam pajtuar se do të ishte e arsyeshme bindëse e nevojshme dhe e domosdoshme me shfuqizu vendimin e kuvendit të komunës përkatësisht dy vendimet e kuvendit të komunës përmes një vendimi që të demonstrojmë vullnetin politik por edhe ligjor si dhe përkushtimin tonë të përbashkët që të ju krijojmë lehtësira investitorëve potencial. Ne jemi në kapitalizëm dhe kemi infrastrukturë të mjaftueshme edhe akte nënligjore që e rregullojnë mjaft mirë se cilat hapa duhet të ndërmerren që të sigurohemi bashke që bizneset apo edhe investitorët e huaj apo edhe investitorët strategjik që të sigurohemi bashke se po krijojmë lehtësira dhe mundësi reale për ti shfrytëzuar bizneset që po krijojnë vlerë të shtuar në komunën tonë. Është e pakuptimtë që me ardh një biznes dhe me ia pagu për çështje të shfrytëzimit një pronë komunale në shumen prej 7000 euro në muaj. Është e pakuptimtë që ne si ekzekutiv dhe si kuvend i komunës ta dërgojmë mesazhin që nuk mundeni as me apliku për shkak se kostoja sipas rregullores që ne e kemi apliko është shumë e lart dhe pavarësisht që komisioni ka bërë një përpjekje për korrigjim apo përmirësim atëherë përsëri ka dalë shumë e lartë. Pra, ne besoj që duhet të pajtohemi të gjithë që të fusim në funksion një akt tjetër nënligjor e jo këtë që e kemi, krejt kjo varësisht prej situatës për shkak se e kemi prioritetin e të hyrave dhe duhet me marr të hyra nga diçka, atëherë jemi në rregull për këtë, por duhet ta kemi parasysh edhe mjedisin miqësor që e kemi me bizneset. Kështu që nuk ka asnjë arsye që me kundërshtu nëse ndiqen procedurat që me herët i përmendi Burim Krasniqi, pasi është kuvendi që ka me i caktu kriteret, pra kuvendi është ai që ka për detyrë me demonstru vullnetin politik dhe njerëzor për zhvillim ekonomik si hapje të vendeve të reja të punës, lehtësira për biznese dhe shumëçka që është vlerë e shtuar e që i jep mundësi komunës tonë me pas fakte që e bëjnë me u ndie komunën tonë mirë e krenarë sa u përket investimeve. Pra unë jam për shfuqizimin e vendimeve dhe nuk po besoj që ka arsye me i dhanë konotacion tjetër pasi e dini se nuk ka konkuru askush, pasi projektin që e ka paraqit dikush para komisionit nuk ka asnjë lloj sigurie që mundet me i realizu ato të hyra për komunën në baza mujore. Pra mesazhi është me i ftu bizneset dhe me operu në një mjedis miqësor pasi rregullorja që e kemi bërë nuk ka funksionuar edhe kjo është arsyeja që duhet me i shfuqizu dy vendimet e kuvendit. Pra rregullorja e re është mundësi e artë për ata që duan të operojnë në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, edhe kriteret që i jep Kuvendi i Komunës.

Lirigzon Kastrati – Meqenëse kam qenë pjesë e këtij komisioni, e ndiej për obligim të i njoftojë anëtarët e kuvendit pasi nuk kemi të i japim konotacion tjetër as politik apo diçka tjetër. Kemi mbajtur dy herë takim si komision për dhënien në shfrytëzim dhe kemi ofruar çmimet edhe me të larta edhe çmimet minimale, të cilët kanë dështuar. Po ashtu edhe unë pajtohem ë bizneseve me iu kriju lehtësira dhe me sjellë investitor sa me shumë dhe gjithashtu e përkrahim propozimin ashtu siç e deklaroi edhe shefi i grupit të LDK-së, z. Burim Krasniqi.

Dëfrim Kafexhiu – Unë do të ndërlidhem me kryetarin, ku thotë që komuna duhet me kriju ambient miqësor me bizneset. Kryetar, ju keni mjaft kompetenca me kriju ambient komod me biznese dhe me investu këtu, pasi ka shumë lehtësira që komuna mundet me iu sjellë bizneseve që me investu. Kështu që sa u përket lehtësirave që ju po i krijoni, ju po doni me kriju lehtësira në formën jo të duhur dhe nuk do të ishte mirë me e dezinformu opinionin publik që me 0,05 m² sipas çmimit që është në atë rregullore, nuk del që është 7000 euro pasi 25,000 m² nëse e llogarisim nga 0,5 cent, atëherë bëjnë 1250 euro pasi nën këtë çmim komuna nuk mundet me dhënë pasi kjo është në rregullore që ka dal nga ky kuvend. Po ashtu të lehtësirat, ju edhe investimeve humanitare nuk mundeni me iu kriju lehtësira e lëre bizneseve, pasi bizneset e kanë gjetur formën ku me ushtru funksionin e vet. Këtu në komunën e Rahovecit ka shumë pengesa që ju me mendësinë e juaj politike e keni krijuar dhe ju kot bëni lehtësira të tjera.

Kryetari – Edhe njëherë i kemi propozuar kuvendit të komunës për ta shfuqizuar vendimin që bazohet në rregulloren për taksa, tarifa e gjoba, e ajo është rregullorja e kuvendit, mirëpo ne duam të aplikojmë rregulloren për lehtësira të bizneseve. Kështu që ne duam të ia falim për 5 vitet e para dhe ky është synim i

çdo qeverie komunale e po ashtu edhe i çdo qeverie që udhëheq ne Republikën e Kosovës. Pasi me këto lehtësira bizneseve ju kërkojmë tjera forma që janë vlerë e shtuar për komunën tonë. Pra, nëse komuna tjera aplikohet për 5 vjet pa taksa hiq atëherë edhe ne duhet që ta aplikojmë rregulloren e tillë që me pas mundësi me ju fal bizneseve pas asnjë taksë që me operu për 5 vjet. Kështu që kjo shumë është e papërballueshme për bizneset pasi nëse i ka 10 punëtorë atëherë duhet që të ju pe rroga edhe i mbajnë familjet e tyre, i paguajnë trustin, sigurimin shëndetësor e taksa të tjera, kështu që neve na duhet një vlerë e shtuar, pasi edhe si qytetar kur kritikojmë se po krijohen pengesa për bizneset kurse ne anën tjetër po kërkonim me i ngarku bizneset pasi është fryme e qeverive të Kosovës dhe gjithashtu edhe e komunave të Kosovës. Pra edhe me kushtin që e kemi zbritur ne minimum nuk kemi pasur asnjë aplikues prandaj edhe i kërkoj falje publikut që qysh në mandatin tim të parë në kuvend të komunës me miratim një rregullore pasi ka qenë edhe kërkesë edhe USAID-it e po ashtu edhe organizatave që merren me mjedise miqësore për biznese kanë thënë se duhet që ta miratoni këtë rregullore se duhet me i liru bizneset nga taksat komunale se paku në 5 vitet e para. Dhe unë jam për me votu për shkak se duhet me u shfuqizu dhe i hap horizonte kësaj komune.

Hasan Përboqi – Në emër të grupit të Aleancës, pajtohem me plotësi që me u shfuqizu ky vendim, arsyet i dha drejtori e po ashtu edhe disa nga anëtarët e këtij komisioni që pikërisht është votuar nga ana e kuvendit. Arsyeja që ne grup i ofrojmë mbështetje që me u shfuqizu është që vetë bizneset nuk kanë interesim për me apliku. Nuk ka interesim edhe pse llogaritet si investim pak me serioz dhe ne e dimë që investimet pak më serioze kërkojnë një periudhë me afatgjatë. Nëse nuk ka pasur interesim me 1250 euro asnjë biznes me apliku, atëherë nëse atij biznesi i duhen dy vite të paktën për me realizu investimin e tij, atëherë Brenda dy vite i duhen mbi 30,000 euro që me hy në obligime ndaj komunës vetëm për qira për dy vite dhe ende pa ja nisë me ushtru veprimtarinë e vet. Kështu që nuk po besoj që është e logjikshme kjo për me i tërheq bizneset dhe kjo vetëm i largon bizneset pasi është një shumë e madhe vetëm për qira ndaj komunës pa i llogaritur investimet, punëtorët e të gjitha të tjerat. Kështu që me këtë logjikë edhe nuk ka pasur interesim nga asnjë biznes për me marrë në shfrytëzim dhe për këtë arsye ne e përkrahim që me u shfuqizu ky vendim edhe ne të ardhmen me na ardh një vendim me i liru, pse jo të gjitha bizneset që janë të interesuara për investime me serioze.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime tjera sa i përket kësaj pike, e hedhim në votim. Me 21 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, votohet kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

8. Shqyrtimi i vendimit për organizimin e mësimi joformal në institucionin e arsimit dhe aftësimi profesional në shkollën “Selajdin Mullabazi-Mici”.

Avni Morina – Përshëndetje për ju kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit dhe gjithë ju të pranishëm. Drejtoria Komunale për Arsim është e interesuar që të filloj procesin e organizimit të arsimit jo formal në institucionin e arsimit dhe aftësimi profesional në shkollën “Selajdin Mullabazi-Mici”, në Rahovec. Kjo nismë është krejtësisht e arsyeshme sepse bazohet në tri faza themelore dhe këto janë në ligjin për arsim dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës në ligjin Nr.04/L143, neni 2, pikat 1.7 dhe 1.8, bazohet në nevojat dhe kërkesat e vazhdueshme të kandidatëve të moshës së rritur që të ndjekin procesin e arsimit joformal për shkak të nevojës së avancimit të tyre profesional. Deri më tash në DKA, kemi pranuar 30 kërkesa nga kandidatët e gjithashtu ka edhe kërkesa të tjera që kanë ardhur në shkollën profesionale dhe që nga ajo që kemi pranuar në DKA, mbi 2/3 janë femra ndërsa të tjerët janë meshkuj. Dhe arsye tjetër është se në shkollën profesionale “Selajdin MULLABAZI-Mici” kemi kuadro të mjaftueshme profesionale që mundësojnë realisht të realizohet pa asnjë pengesë arsimit dhe aftësimi profesional për të rritur në tri drejtime të cilat përmbajnë edhe profile të caktuara profesionale. Drejtimet të cilat ne synojmë t'i hapim janë këto: drejtimi Ekonomi, me profilin tregti me pakicë dhe shumicë, kontabilitete, pastaj drejtimi makineri (instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit) dhe drejtimi teknologji ushqimore (përpunues i produkteve ushqimore). Këto janë tri drejtimet që për fillim ne i kemi propozuar e që ndërkohë mund të ketë kërkesa kur

te hapet thirrja edhe për drejtime tjera profesionale te cilat ne i kemi te akredituara nga MASHT-i. Për këtë arsye si DKA, ju kemi drejtuar juve kuvendit te komunës dhe bazuar ne këto arsyetime themelore kërkojmë nga kuvendi komunal që te përkrah dhe te mbështes këtë nismë e cila është ne interes te komunitetit dhe komunës tonë, në mënyrë që te plotësohen kuotat e nevojshme e kuadrove ne përputhje me nevojat e tregut të punës te cilët kanë nevojë për avancimin e tyre ne fushat dhe profilet profesionale të IAAP-së “Seladin Mullabazi-Mici”, ne Rahovec.

Burim Krasniqi – Unë e kam një propozim te ky vendim, në qoftë se nuk ka ndonjë pengesë ligjore ne kuptimin e akreditimit. Kështu që unë po propozoj që pikës 1, t’i shtohet pika 1.4, drejtimi ndërtimtari (murator, suvatues) edhe gjithashtu t’i shtohet edhe pika 1.5, profili elektro (instalues i rrymës). Këto janë profile që kanë me pas kërkesa te vazhdueshme, nëse nuk ka pengesa ligjore sa i përket akreditimit, le te mbetet pjese e vendimit dhe t’u krijohet mundësi e barabartë edhe profileve tjera që qytetarëve, të rinjëve, që parimisht sot janë njohës te punës, sepse kemi plot qytetarë që punojnë instalues te rrymës, murator apo suvatues, por që nuk kanë një dokument valid që e prezantojnë për aftësimin e tyre profesional që t’u mundësohet me këtë shkollim joformal të legjitimohet aftësia e tyre profesionale.

Dëfrim Kafexhiu – Përshëndetje për te gjithë. Meqenëse kërkesa ka ardhur prej Drejtorisë se Arsimit, drejtuar kryesuesit te Kuvendit dhe anëtareve te Kuvendit, nuk janë te bashkangjitura kërkesat e kandidateve te cilët kanë interes për vijimin e këtij mësimi joformal. Po ashtu unë kam një pyetje pasi do të bëhej sipas legjislacionit ne fuqi edhe një koordinator apo koordinate e këtij mësimi joformal, kështu që unë po du me supozu se Shqipe Kryeziu do të jetë koordinate e këtij mësimi joformal që rrjedhimisht po jep hapësirë për keqpërdorime tjera sikurse edhe janë duke ndodhur ne sistemin arsimor te komunës se Rahovecit d.m.th. do te fillojë me u bë një mënyrë tjetër e tregtisë me shkollimin e mesëm pasi kemi dyshime dhe do te shohim ne vijim se çfarë do të ndodhë.

Shqipe Kryeziu – Drejtor, jeni për çdo lëvdatë dhe ne emër te gjitha atyre grave që kanë sjellë kërkesa të ju dhe ne institucionin e arsimit dhe aftësimit profesional, ju falënderoj ne emër te gjithë atyre grave që dikur nuk e kanë pasur mundësinë me u arsimu për shkak te shume kushteve dhe rrethanave të kohës duke ditur mentalitetin si ka qenë. Sa i përket perceptimit te gabuar nga kolegu Dëfrim Kafexhiu, unë i them se Shqipja nuk ka interesim me u bë koordinate aty, pasi kam mbi 17 vite ne arsim dhe ka mungesë te fizikanëve, jam ne gjendje me punu pa pagesë, pasi jam magjistre e fizikës dhe dua të punoj ne lëndët e mia të fizikës. Pra unë jam në mbështetje të plotë për arsimimin dhe avancimin e grave, pasi edhe vetë jam grua. Gjithashtu me pëlqeu ideja e kolegut Burim Krasniqi, që ne këtë shkollë do të ketë mundësi që ne vazhdimësi me kriju edhe drejtime tjera pos shëndetësisë atyre që u përmendën nga drejtori.

Kryetari – Shpresoj që te ketë kërkesa sa me shume nga të dy gjinitë, për ta shfrytëzuar të drejtën për me pas një praktikë të suksesshme të mësimi joformal. Unë e falënderoj drejtorin e Arsimit për akceptimin, por gjithashtu edhe iniciatoren pasi e ka artikuluar dhe e ka paraqitur ne KPF. Kështu që propozoj që me hedh ne votim sepse është diçka që i bën nder kësaj komunë e që ndoshta mund te them se mund te jetë edhe e vonuar. Por, meqenëse është e paraparë edhe me udhëzim administrativ por edhe me infrastrukturë ligjore do të ishte mirë që sa me shpejt me fillu punën. Kurse sa i përket se kush do te behet koordinator, unë mendoj se njerëzit që kanë ambicie te shëndosha kushdo qoftë ai person qoftë edhe prej juve dikush, mendoj se nuk ka asnjë parregullsi. Pra te gjithë ata që dëshirojnë me realizu një të drejtë dhe mendoj se duhet që ta votojmë këtë pikë shume te rëndësishme sa i përket mësimi joformal ne komunën e Rahovecit.

Burim Krasniqi – Me herët e dhashë një propozim që vendimit të i shtohen edhe dy pika si profile te caktuara pra murator dhe suvatues e po ashtu edhe elektrikist dhe elektroinstalues. Si dy profile që mundem me iu ndihmu shume ne te ardhmen të rinjve pasi janë me shkolle fillore mirëpo kanë aftësimin profesional nga praktika që e kanë bërë.

Avni Morina – Ne i kemi paraqit profilet aktuale që i kemi mirëpo prej atyre profileve i kemi propozuar vetëm ato që kemi pasur kërkesa deri me datën kur e kemi bërë kërkesën për kuvend. Përndryshe, nëse merret vendimi prej kuvendit që të filloj aktiviteti atëherë ne e hapim thirrjen dhe jemi në koordinim të plotë edhe me ministrinë e arsimit dhe pastaj nuk kufizohemi në drejtime pasi mund të fusim të gjitha profilet që na konvenojnë edhe që e kemi kuadrin profesional në shkollë pasi nuk mund të hapim një drejtim pasi nuk kemi kuadër. Por e di shumë mirë se përveç këtyre tri që i kemi propozuar gjithashtu kemi edhe për makineri, intsalues i ujit, kanalizimit e shumë drejtime tjera por ato tri profile i kemi veçuar për shkak se deri me tash kemi pasur kërkesa për ato drejtimeve. Kështu që kur të hapim thirrjen, mund të hapim edhe profile të tjera që mund të ja shtojmë këtij vendimi edhe profile tjera që neve na konvenojnë edhe që i kemi kuadrot e mjaftueshëm për të realizuar këto profile.

Burim Krasniqi – Kjo nënkupton që këtij vendimi nuk ka asnjë pengesë ligjore me ia shtu edhe propozimin që e dhashë e po ashtu në fund me cekë edhe profile tjera sipas kërkesa të qytetareve të komunës së Rahovecit, që mos me pas nevojë me marr edhe një vendim tjetër për një profil të caktuar, por me iu dhënë të drejtën e barabartë të gjithë atyre që kanë nevojë për shkollim joformal profesional duke mos rënë ndesh me të drejtën e akreditimit që e kemi edhe me kuadrot profesionale që i kemi.

Kryetari – Kërkoj nga kuvendi që me miratim këtë pikë, drejtorin e mirëkuptova me shpjegimin që e dha e po ashtu edhe Burim Krasniqi ka të drejtë edhe me atë plotësim-ndryshim, pasi nuk kemi nevojë me kufizu asgjë, sigurisht me propozimin shtesë nga Burim Krasniqi.

Ilir Pallqa – A do të ketë seancë të jashtëzakonshme shpejt rreth PZHK-së?

Kryetari – Mezi po pres që me ardh pëlqimi, sigurisht se me shumë urgjencë do ta kemi, sigurisht nëse e lejon ligji edhe besoj që nuk do të mungoni pasi duhet me qenë të pranishëm.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi diskutime tjera, e qesim në votim me propozimin shtesë nga Burim Krasniqi. Me shumicë të votave aprovohet kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për shpalljen QYTETAR NDERI të Komunës së Rahovecit, z. Eric Rathfelder, gazetar i Republikës së Gjermanisë.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë. Është e natyrshme që qytetaret e një vendi të pushtuar e kanë për obligim njerëzor, moral por edhe qytetar, kombëtar e atdhetar që t'i shërbejnë vendit të vet, që të sakrifikohen e të flijohen siç i ka ndodhur gjatë gjithë historisë popullit shqiptar por edhe popujve tjerë. Pra përveç interesant por edhe shumë sfiduese nëse një qytetar i një vendi të huaj i cili e ka ditë se ku gjendet Jugosllavia e që shteti i tij e ka mbajtur një raport për shkak të luftës së dytë botërore rreth pasojave dhe ka ardhur në vitin 1987 dhe ka filluar me u marr me trajtimin dhe paraqitjen e ngjarjeve në çdo republikë e krahinë autonome të Jugosllavisë e që ka mbërri me i akceptu edhe me demonstroi se sa realisht është një gazetar gjerman i cili ka qenë gazetar i njohur dhe që është futur thellësi të gjitha zhvillimeve në procesin e shkatërrimit të ish-jugosllavisë dhe luftërave që kanë ndodhur në Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Kosovë. Pra, gazetari i njohur Eric Rathfelder, i cili për shkak të pasqyrit të drejtë dhe raportimit të drejtë të asaj që ka parë edhe në Republikën e Kosovës dhe gjithkund tjetër, kështu që mendoj se ka dhënë kontribut që me ardh me shpejt liria dhe demokracia për popujt e shtypur. Ai ka ardhur në Kosovë qysh në vitin 1987, pasi e kam lexuar librin e tij „Historia e një konflikti“, dhe nuk e kam ditur deri pak dite se kush është me të vërtetë Eric Rathfelder. Fakti është se në luftimet e përgjakshme që kanë ndodhur në qytetin e Rahovecit nga 17.07 deri 26.07.1998, përshkruan situatën të tmerrshme dhe paraqet krimet që i ka bërë Serbia dhe forcat pushtuese serbe në Rahovec. Raportimet për Rahovecin me rrethinë pra për krimet e mëdha që kanë ndodhur në Komunën e Rahovecit, kështu që për shkak të raportimeve të drejta që i ka bërë gjatë periudhës së korrikut 1998 duke hyrë edhe në zonën të thellë të luftës duke i paraqitur para botës të gjitha vrasjet dhe krimet barbare që i kanë bërë forcat serbe e po ashtu e ka

paraqitur edhe vrasjen e Sheh Myhedinit dhe plot situata tjera ne mediat gjermane dhe janë bërë lajm ndërkombëtar. Dhe qysh te nesërmen, Serbia me institucionet veta vendos me shpall person nongrata dhe e ndjek me vra për shkak te raportimeve që i ka bërë për krimet e kryera ne komunën e Rahovecit. Por nga vrasja e ka shpëtuar një gazetar serb dhe është larguar nga Kosova me dhunë dhe ka filluar procesin e hulumtimit dhe nga ajo që ka parë ka kërkuar nga qeveria e shtetit te vet pra qeveris gjermane, ministrit te mbrojtjes dhe ministrit te punëve te jashtme Joshka Fischer përmes kolegëve te vet gazetar e gjithashtu edhe Brukselit zyrtar edhe Shteteve te Bashkuara te Amerikës që sa me shpejt me fillu bombardimet kundër forcave serbe. Ne kemi nderi që ta kemi prezent ne sallën e kuvendit komunal z. Eric Rathfelder dhe bashkëshorten e tij, që do t'i ndahet dekorata Qytetar Nderi, ku si gazetar gjerman ka regjistruar, ka marrë shënime dhe ka rreziku jetën e vet dhe nga Rahoveci me raportimet e tij ne media te huaja që marrin peshë te madhe neper botë sa që reagon regjimi i Beogradit me largu prej Kosovës dhe me shpall person nongrata. Librin e kam lexuar pasi është ne shitje ne shtëpinë botuese Artini dhe po besoj që është nder i madhe që një gazetar gjerman me dhanë kontribut për të mirën e popullit te Kosovës e veçanërisht te Rahovecit duke pasqyruar te vërtetën për Kosovën. Dhe ne atë kohë, propaganda e shtetit serb ka qenë se shqiptaret e Rahovecit po i sulmojnë serbët mirëpo ky e ka demonstruar me fakte e dëshmi që e vërteta për Rahovecin nuk është ashtu si po e thotë Serbia. Prandaj është nder i madh me ja dhanë dekoratën qytetar nderi ne emër te qytetareve te Komunës se Rahovecit, ne emër te gjithë atyre që kanë rënë ne luftën për liri martireve, dëshmorëve dhe gjithashtu gjithë atyre që janë invalid dëshmorë dhe gjithë atyre që e respektojnë dhe nuk e harrojnë te kaluarën por i shërbejnë edhe sot e kësaj dite të ardhmes. Gjithashtu dua që ta falënderoj z. Islam Spahiun që ka marr iniciativën që është nga komuna jonë, nga fshati Opterushë, që është diplomat, gazetar që ka punuar ne Deutsche welle dhe tani është në misionin diplomatik te Republikës se Kosovës ne kuadër te Ministrisë se jashtme i cili ka dhënë idenë për këtë dhe ne me shume kënaqësi e kemi pranuar. Kështu që besoj se kuvendi i komunës me shpall qytetar gazetarin e gjerman z. Eric Rathfelder e nderon vetën dhe gjithë qytetaret e komunës tonë pasi një gazetar gjerman propagandën nacionaliste kundër shqiptareve te Kosovës, sllovenëve, kroatëve, boshnjakëve, por edhe kundër popullit te Kosovës e veçanërisht qytetareve te Rahovecit.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, në radhë te parë faleminderit për pranimin e propozimit nga z. Spahiu për shpalljen qytetar nderi dhe unë po besoj që diskutime nga ana jonë do te ketë edhe ne seancën solemne ku do te jemi edhe falënderues për gazetarin Eric Rathfelder për vlerat dhe kontributin e tij për komunën e Rahovecit. Unë i kam dy çështje tjera, e para tek vendimi a është gabim teknik apo duhet me mbet ashtu, pra vendimi 00/000, i datës 00/00/2020, pasi mendoj se duhet me qenë numri i propozimit e mandej vendimi e merr numrin e vet po besoj. Kështu që duhet te rishikohet para se me qit ne votim, ku thotë miratohet propozimi i kryetarit te komunës Nr. i propozimit te kryetarit te komunës që e mban datën e propozimit. Pastaj e dyta, për drejtorin e Financave, ju rekomandoj si asamble komunale që t'i blejmë librat për asambleistët, te gazetarit Eric Rathfelder, që ta kemi secili asamblist nga një kopje te librit që me pas mundësi me pa atë që e ka pershkruar personi te cilin e shpallim qytetar nderi.

Feriz Thaqi – Përsëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asambleistë dhe gjithë te pranishmit. Unë librin do ta blej vetë dhe s'ka nevojë me ma ble komuna.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e hedhim ne votim këtë pikë te rendit te ditës. Me shumicë te votave te anëtareve te kuvendit, miratohet edhe kjo pikë e rendit te ditës.

Të nderuar anëtar te kuvendit, konstatoj te mbyllur mbledhjen e sodit dhe shihemi ne seancën solemne që planifikohet të mbahet ne ora 14:00.

Rahovec:29.11.2023

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13, nenit 14.1, nenit 17 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*” Nr. 28/2008”), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i:

PROPOZON

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë

1. Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i propozon iniciimin e procedurës për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510066-00386-1** në Zonën Kadastrale Pastasellë, në sipërfaqe prej 10715m² (dhjetëmijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22005m² (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) në vendin e quajtur seishte-seishte, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të PASURI SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKO.E PYJEVE RAHOVEC.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë “Këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror për ndërtimin e SHFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasellë”.
3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronave në Librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
4. Për zbatimin e këtij Propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
5. Ky propozim hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

Të njoftohen:

- *Kuvendi i Komunës,*
- *Sekretaria e Kuvendit,*
- *Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 11/23

Rahovec, 17.11.2023

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e njëmbëdhjetë (11), e cila do të mbahet më **29 nëntor 2023 (Mërkurë)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim paraprak të pronës së paluajtshme komunale P- 01057-2 ZK- Xërxë, personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër 1-15 vjet;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01728-1 ZK-Rahovec;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-02240-1 ZK-Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01422-1 ZK-Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510033-00550-2 ZK-Xërxë;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-00386-1, në zonën kadastrale Pastasellë;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e Raportit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

KRYESUES I KUVENDIT

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019*”), nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.11.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 10 (dhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 000/23 i datës 29.11.2023 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510033-01057-2 dhe P-71510033-01043-1 në zonën kadastrale Xërxë.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. Berat Duraku, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.2. Besmire Bytyqi, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.3. Feriz Thaqi, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës -AAK;
 - 2.4. Faton Ramadani, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - LDK
 - 2.5. Nazmi Bellaqa, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 10 (dhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivi***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.154/23
Datë:29.11.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12, nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-049, nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2023”), nenit 10, nenit 39 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.11.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024

- Miratohet** vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.
- Normat tatimore të cekura në pikën 1 të këtij vendimi janë si në vijim:

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësité bujqësore të parcelave	0.16 %
Për njësité bujqësore të objekteve	0.16 %
Për njësité pyjore të parcelave	0.16 %
Për njësité rezidenciale të parcelave	0.12 %
Për njësité rezidenciale të objekteve	0.19 %
Për njësité komerciale të parcelave	0.17 %
Për njësité komerciale të objekteve	0.17%
Për njësité industriale të parcelave	0.16%
Për njësité industriale të objekteve	0.16 %

- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë në Komunën e Rahovecit.
- Ky vendim do të filloj së zbatuari nga data 1 Janari 2024.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Ministrisë së Financave,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrës së Tatimit në Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.160/23
Datë:29.11.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008*”), nenit 5, nenit 6, paragrafi 1, pika 1.1 dhe nenit 8, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5, paragrafi 1, pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë: 29.11.2023 merr këtë:

V E N D I M
Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/3339/23, i datës 07.11.2023 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, janë:
 - 2.1. Parcela, sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01057-2, në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur *skeja*, me kulturë Kullosë e klasës së 2-të, në sipërfaqe të përgjithshme prej 571m² (pesëqind e shtatëdhjetë e një metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit;
 - 2.2. Parcela, sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01043-1, në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur *skeja*, me kulturë Kullosë e klasës së 3-të, në sipërfaqe prej 1000m² (një mijë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5016m² (pesë mijë e gjashtëmbëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe t’u jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Parcela e cekur në pikën 1 të këtij propozimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 01 Nr. 2566, të datës 30.5.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet brenda Zonës Ndërtimore.
5. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh.
6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t’i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana

e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**, sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.153/23
Me datë: 29.11.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, nenit 12 paragrafi 1 pika 1.6 të Rregullores (QRK) – Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.11.2023 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Raportit të Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

1. Me këtë vendim **miratohet** Raporti i Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera i datës 08.11.2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **Agjencisë për Menaxhimin Emergjent,**
- **Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.161/23
Datë: 29.11.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.11.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510033-00550-2 në Zonën Kadastrale Xërxë

- 1. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/3332/23, i datës 07.11.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510033-00550-2** në Zonën Kadastrale Xërxë, në sipërfaqe prej 42m² (dyzet e dy metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 100m² (njëqind metra katror) në vendin e quajtur *luga-luga*, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në bashkëposedim të Bashkim (Shpend) Sinanit, Lulzim (Shpend) Sinanit dhe Shpejtim (Shpend) Sinanit.
- 2.** Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë “Këmbimi i pronës private me pronën komunale”- Për zgjerimin e rrugës publike – Komunale.
- 3.** Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.** Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin kadastral, do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- 5.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- 6.** Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Anëtarëve të Kuvendit,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.11.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01422-5 në Zonën Kadastrale Rahovec

- 1. Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/3323/23, i datës 07.23.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510057-01422-5** në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 132m² (njëqind e tridhjetë e dy metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 679m² (gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë metra katror) në vendin e quajtur *Kanal-kanal*, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.Sh.E KOSOVES K.K.RAHOVEC UJRAT.
- 2.** Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror, për funksionalizimin e sheshit qendror të qytetit në Rahovec.,
- 3.** Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.** Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin kadastral, do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- 5.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- 6.** Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01Nr.157/23
Datë: 29.11.2023

Kuvendit

Arbër Zenuni

Kryesues

i



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.11.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01728-1 në Zonën Kadastrale Rahovec

- 1. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/3328/23, i datës 07.11.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510057-01728-1** në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 9m² (dymbëdhjetë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 430m² (katërqind e tridhjetë metra katror) në vendin e quajtur *strane*, me kulturë Kullosë e klasës së 2-të, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Agim (Xhafer) Kastratit.
- 2.** Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë shpronësimi i pronës private, për vendosjen e trafos elektrike.
- 3.** Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.** Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin kadastral, do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- 5.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- 6.** Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivët.*

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01Nr.155/23
Datë: 29.11.2023

Kuvendit

Arbër Zenuni

Kryesues

i



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.11.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-02240-1 në Zonën Kadastrale Rahovec

- 1. Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/3322/23, i datës 07.11.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510057-02240-1** në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 30000m² (tridhjetë mijë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7577401m² (shtatë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e një metra katror) në vendin e quajtur *shume-kabilja glava*, me kulturë Mal i klasës së 5-të, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.Sh.E KOSOVES K.K.RAHOVEC ShF.EKO.E PYJ.RAHOVEC.
- 2.** Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror. Për zhvillimin e aktiviteteve biznesore dhe t’u jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
- 3.** Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.** Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin kadastral, do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- 5.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- 6.** Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (*“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”*), nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.11.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë

- 1. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/0000/22 i datës 00.00.2022 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510066-00386-1** në Zonën Kadastrale Pastasellë, në sipërfaqe prej 10715m² (dhjetëmijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22005m² (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) në vendin e quajtur seishte-seishte, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të PASURI SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKO.E PYJEVE RAHOVEC.
- 2.** Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë “Këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror për ndërtimin e SHFMU “Milaim Krasniqi” në Pastasellë”.
- 3.** Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.** Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
- 5.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
- 6.** Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Anëtarëve të Kuvendit,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01Nr.159/23
Datë:29.11.2023

Kuvendit

Arbër Zenuni

Kryesues

i

